

EPPC Albania kërkon një **Menaxher Projekti i Dixhitalizimit dhe Strategjisë së Medias**, për klientin e saj, kompani e specializuar në menaxhimin e pasurive të paluajtshme dhe qendrave tregtare.

## Përgjegjësitë kryesore:

- Krijon, propozon dhe planifikon strategjikisht prezencën e qendrave dhe të gjithë subjekteve të tjera që kompania ka apo mund të ketë në portofol në mediat sociale, të gjitha kanalet e komunikimit që ka si: Instagram, Facebook, YouTube, LinkedIn, WEB, Aplikacione Mobile etj;
- Krijon, propozon dhe planifikon strategjikisht prezencën e qendrave dhe të gjithë subjekteve tjera që kompania ka apo mund të ketë në portofol në mediat sociale, në të gjitha kanalet e komunikimit digital të nevojshme jashtë kompanisë për qëllime PR apo reklamimi;
- Planifikon dhe organizon strategjikisht fushatat dixhitale në përputhje me objektivat vjetor të kompanisë dhe në bashkëpunim me ekipin e marketingut, agjencitë e marketingut;
- Përgjegjës për planin strategjik dhe zbatimin e reklamave në të gjitha kanalet (WEB, SEO/SEM, GDN, Adwords, social media, portale, kanale të ndryshme dixhitale etj);
- Ndërmerr iniciativa sipas objektivave të përcaktuara për të gjitha kanalet dixhitale në bazë të vlerësimit të raporteve që gjeneron;
- Gjeneron raporte dhe interpreton KPI për propozimin e masave për përmirësimin e performances dhe ndërmerr masat e nevojshme për arritjen e objektivave;
- Koordinon dhe menaxhon përmbajtjen në çdo kanal dixhital duke përfshirë të gjithë të interesuarit, qiramarrësit, departamentet e tjera të kompanisë etj;
- Monitoron, mat dhe raporton performancën e fushatës në baza ditore kundrejt pritshmërive të dakordësuara dhe ndërton raportet e nevojshme për të gjithë palët e përfshira;
- Programon përmbajtjen dhe menaxhon buxhetin përkatës të reklamave për arritjen e objektivave të kanalit dixhital sipas buxhetit të planifikuar;
- Propozon në mënyrë proaktive zgjidhje të reja, aktivizime për të angazhuar audiencën dhe për të përmirësuar përvojën e përdoruesit;
- Është përgjegjës/e për zhvillimin e të gjithë projekteve dixhitale që lidhen me departamentin e marketingut që dixhitalizojnë proceset, shërbimet dhe gjithçka që lidhet me eksperiencën e klientit;
- Është përgjegjës/e për të zhvilluar CRM dhe për të ndërmarr plane strategjike për shfrytëzimin e databazës për qëllime marketimi dhe rritjen e eksperiencës së klientit;
- Përgjegjës /e në aspektin strategjik deri në daljen on air të të gjithë kontentit/përmbajtjes për kanalet e sipër përmendura;
- Identifikon mundësi dhe mënyra të reja për të pasur pozitën nr.1 në ndërgjegjësimin online, të marrë standardin e vazhdueshëm të aktorëve të sektorit, në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

## Kërkesat për këtë pozicion janë:

- Diplomë Universitare në **Marketing, Administrim Biznesi, Teknologji Digitale & Gazetari**.
- **Minimum 5 vjet përvojë pune në të njëjtin pozicion ose pozicione të ngjashme;**
- Të zotëroj shumë mirë gjuhën Angleze dhe të ketë njohuri shumë të mira kompjuterike;
- **Njohuri dhe përvojë teknike në marketingun dixhital, tregtinë elektronike, shërbimet e përmbajtjes, aplikacionet celulare, analitikën e të dhënave;**
- Aftësi të shkëlqyera komunikimi, prezantimi, bashkëpunimi, organizimi dhe menaxhuese;
- Aftësi për vendim-marrje të pavarur brenda kompetencave të pozicionit.

## Si të aplikoni:

Për të aplikuar për këtë mundësi punësimi, ju lutem dërgoni CV-në tuaj në:

<https://aplikim.eppc.al>

Ju do të kontaktoheni vetëm nëqoftëse CV-ja juaj do të kualifikohet.